Republika e Kosovës

*Komuna e Rahovecit*

**Kabineti i Kryetarit**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No. 2323 Nr. i faq/Br.str/No.pg 366
Data/Datum/Date 4 / 5 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

## LISTA E VENDIMEVE NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT, Z. SMAJL LATIFI: PRILL 2022

| Nr | Emri i vendimit | Nr. Protokollit |
|---|---|---|
| 1. | Vendim për caktim komisioni | NRP-02-1830-2022 |
| 2. | Vendim për mbulimin e shpenzimeve të bashkësive fetare | NRP-02-1831-2022 |
| 3. | Vendim emërim i drejtorit Berat Duraku | NRP-02-1833-2022 |
| 4. | Vendim emërim i drejtorit Afrim Limani | NRP-02-1835-2022 |
| 5. | Vendim emërim i drejtorit Erhan Morina | NRP-02-1837-2022 |
| 6. | Vendim emërim i drejtorit Nora Boshnjaku | NRP-02-1839-2022 |
| 7. | Vendim emërim i drejtorit Kujtim Dina | NRP-02-1840-2022 |
| 8. | Vendim emërim i drejtorit Albnor Mullabazi | NRP-02-1832-2022 |
| 9. | Vendim emërim i drejtorit Avni Morina | NRP-02-1834-2022 |
| 10. | Vendim emërim i drejtorit Afrim Oruqi | NRP-02-1836-2022 |
| 11. | Vendim emërim i drejtorit Afrim Dina | NRP-02-1838-2022 |
| 12. | Vendim emërim i drejtorit Përparim Krasniqi | NRP-02-1841-2022 |
| 13. | Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 02-584-20 | NRP-02-1843-2022 |
| 14. | Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 02-1830-20 | NRP-02-1845-2022 |
| 15. | Vendim për ndihma financiare | NRP-02-1855-2022 |
| 16. | Vendim për caktim komisioni për asgjësimin e mallit të konfiskuar | NRP-02-1858-2022 |
| 17. | Vendim për heqje të mëditjes Ruzhdi Kabashi | NRP-02-1861-2022 |
| 18. | Vendim për heqje të mëditjes Ymret Reshiti | NRP-02-1862-2022 |
| 19. | Vendim për ndihma financiare | NRP-02-1871-2022 |
| 20. | Vendim për dhënien e pushimit të lehonisë Bukurije Ramadani | NRP-02-1872-2022 |
| 21. | Vendim për caktim komisioni | NRP-02-1873-2022 |
| 22. | Vendim për komision rekrutimi | NRP-02-1876-2022 |
| 23. | Vendim caktim komisioni | NRP-02-1877-2022 |
| 24. | Vendim caktim komisioni | NRP-02-1878-2022 |
| 25. | Vendim ndihmë financiare Fehmi Hoxha | NRP-02-1879-2022 |
| 26. | Vendim ndihmë financiare Rexhep Kryeziu | NRP-02-1880-2022 |
| 27. | Vendim për derivate OVL UÇK | NRP-02-1881-2022 |

| | | |
|---|---|---|
| 28. | Vendim komision rekrutimi | NRP-02-1886-2022 |
| 29. | Vendim ndihmë financiare | NRP-02-1887-2022 |
| 30. | Vendim komisioni komunal për kthim | NRP-02-1889-2022 |
| 31. | Vendim caktim komisioni | NRP-02-1892-2022 |
| 32. | Vendim caktim komisioni | NRP-02-1893-2022 |
| 33. | Vendim caktim komisioni për vlerësimin e investimeve Park Plaza | NRP-02-1894-2022 |
| 34. | Vendim ndihmë financiare | NRP-02-1895-2022 |
| 35. | Vendim ndihma financiare | NRP-02-1896-2022 |
| 36. | Vendim komision rekrutimi | NRP-02-1897-2022 |
| 37. | Vendim komison rekrutimi | NRP-02-1898-2022 |
| 38. | Vendim caktim i zyrtarëve për bazën e të dhënave | NRP-02-1904-2022 |
| 39. | Vendim ndihma financiare | NRP-02-1907-2022 |
| 40. | Vendim caktim komisioni | NRP-02-1908-2022 |
| 41. | Vendim për ndihmë financiare riatdhesim | NRP-02-1909-2022 |
| 42. | Vendim për qasje në dokumente publike nga EC Ma Ndryshe | NRP-02-1924-2022 |
| 43. | Vendim formim komisioni | NRP-02-1928-2022 |
| 44. | Vendim caktim menaxheri | NRP-02-1932-2022 |
| 45. | Vendim caktim menaxheri | NRP-02-1933-2022 |
| 46. | Vendim caktim keshilli organizativ "Java e Dëshmorëve" | NRP-02-1934-2022 |
| 47. | Vendim caktim komisioni per tjetërsimin e pasurisë jofinanciare | NRP-02-1935-2022 |
| 48. | Vendim caktim komisioni për asgjësimin e pasurisë jofinanciare | NRP-02-1936-2022 |
| 49. | Vendim ndihma financiare | NRP-02-1937-2022 |
| 50. | Vendim ndihma financiare | NRP-02-1938-2022 |
| 51. | Vendim ndihma financiare | NRP-02-1939-2022 |
| 52. | Vendim ndihmë financiare | NRP-02-1940-2022 |
| 53. | Vendim caktim komisioni për vlerësim të dëmit ne Palestër | NRP-02-1945-2022 |
| 54. | Vendim caktim menaxheri | NRP-02-1948-2022 |
| 55. | Vendim për ndihmë financiare | NRP-02-1967-2022 |
| 56. | Vendim për ndihmë financiare | NRP-02-1968-2022 |
| 57. | Vendim për ndihmë financiare | NRP-02-1969-2022 |
| 58. | Vendim caktim te ekipit monitorues per implementimin e projekteve të përfituesve të mbështetjes financiare | NRP-02-1971-2022 |
| 59. | Vendim komision rekrutimi | NRP-02-1989-2022 |
| 60. | Vendim komision rekrutimi | NRP-02-1990-2022 |
| 61. | Vendim pagesë shpërblimi jubilar Binak Kryeziu | NRP-02-1991-2022 |
| 62. | Vendim pagesë shpërblimi jubilar MIftar Krasniqi | NRP-02-1995-2022 |
| 63. | Vendim komision rekrutimi | NRP-02-1996-2022 |
| 64. | Vendim për caktimin e zyrtarit përgjegjës për regjistrimin dhe administrimin e kërkesave për banim social | NRP-02-1998-2022 |

| | | |
|---|---|---|
| 65. | Vendim për caktimin e grupit punues për hartimin e Planit për Banim Social në Komunën e Rahovecit | NRP-02-1999-2022 |
| 66. | Vendim për qasje në objekte publike AKEREE | NRP-02-2000-2022 |
| 67. | Vendim për ndërrim të pozicioneve | NRP-02-2001-2022 |
| 68. | Vendim për pagesë për punë shtesë Ilhami Kryeziu | NRP-02-2009-2022 |
| 69. | Vendim për pagesë për punë shtesë Eqrem Kabashi | NRP-02-2010-2022 |

Rahovec, prill 2022

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
II
RAHOVEC
ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Republika e Kosovës/Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit/Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kabineti i Kryetarit të Komunës/Kabinet Predsednika Opštine/Municipal Mayor Cabinet
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1830 Nr. i faq/Br.str/No.pg 346
Data/Datum/Date 01/04/22
RAHOVEC/ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM
**Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: **"Shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e Komunës së Rahovecit"**, me Nr. prokurimi: **623-22-1723-2-2-1 & 623-22-005-2-2-1** të datës: **31.03.2022**, në këtë përbërje:

   **1.1.** Jeton Krasniqi, kryesues
   **1.2.** Arta Kabashi, anëtare
   **1.3.** Liridon R. Gashi, anëtar

2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin **"Shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e Komunës së Rahovecit"**, me Nr. prokurimi: **623-22-1723-2-2-1 & 623-22-005-2-2-1** të datës: **31.03.2022.**

3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1831 Nr. i faq/Br.str/No.pg 346
Data/Datum/Date 01/04/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008") dhe neneve 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

# VENDIM

1. Me të cilin Komuna e Rahovecit merr përsipër mbulimin e shpenzimeve të rrymës për Këshillin e Bashkësisë Islame në Rahovec, Teqenë e Madhe "Shejh Sylejmani" në Rahovec dhe Teqenë e "Haxhi Shejh Ilaz Shehu" në Rahovec.

2. Mbulimi i shpenzimeve komunale të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë për periudhën prej datës 01 Prill 2022 deri me datë 31 Mars 2023.

3. Mjetet do të sigurohen nga kodi për Shërbime Komunale.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Teqesë së Madhe "Shejh Sylejmani" në Rahovec,***
- ***Teqesë së "Haxhi Shejh Ilaz Shehu" në Rahovec,***
- ***Këshillit të Bashkësisë Islame në Rahovec,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPAL RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MAYOR
II
RAHOVEC
ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1852 Nr. i faq/Br.str/No.pg 347
Data/Datum/Date 01.04.22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 pika 2, nenit 17 dhe nenit 23 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015, nenit 74, nenit 81 paragrafi 1.1, nenit 84 paragrafi 1, nenit 85 paragrafi 1 pika 1.6 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit**

1. z. **Albnor Mullabazi** nga Rahoveci, i diplomuar në Fakultetin e Makinerisë dhe Komunikacionit në Universitetin e Prishtinës, **emërohet:**

   **1.1 Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit.**

2. Detyrat dhe përgjegjësitë të drejtorit të drejtorisë janë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015.

3. Ky emërim fillon nga data **01.04.2022** dhe përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Të emëruarit,***
- ***Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyrës së personelit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1833 Nr. i faq/Br.str/No.pg 347
Data/Datum/Date 01 / 04 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 pika 2, nenit 17 dhe nenit 26 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015, nenit 74, nenit 81 paragrafi 1.1, nenit 84 paragrafi 1, nenit 85 paragrafi 1 pika 1.9 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

## V E N D I M
**Për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural**

1. **z. Berat Duraku** nga fsh. Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, me përgatitje profesionale Ekonomist i diplomuar në Universitetin e Prishtinës, **emërohet:**

   **1.1 Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.**

2. Detyrat dhe përgjegjësitë të drejtorit të drejtorisë janë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015.

3. Ky emërim fillon nga data **01.04.2022** dhe përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Të emëruarit,***
- ***Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyrës së personelit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1834 Nr. i faq/Br.str/No.pg. 347
Data/Datum/Date 01/04/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 pika 2, nenit 17 dhe nenit 20 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015, nenit 74, nenit 81 paragrafi 1.1, nenit 84 paragrafi 1, nenit 85 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

## V E N D I M
## Për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë për Arsim

1. **z. Avni Morina** nga fsh. Vrajak, komuna e Rahovecit, me përgatitje profesionale Doktor i Shkencave Fizike në Universitetit Universitetin Teknik të Tiranës, **emërohet:**

   **1.1 Drejtor i Drejtorisë për Arsim në Komunën e Rahovecit.**

2. Detyrat dhe përgjegjësitë të drejtorit të drejtorisë janë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015.

3. Ky emërim fillon nga data **01.04.2022** dhe përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Të emëruarit,***
- ***Drejtorisë për Arsim,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyrës së personelit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1835 Nr. i faq/Br.str/No.pg 347
Data/Datum/Date 01 / 04 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 pika 2, nenit 17 dhe nenit 21 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015, nenit 74, nenit 81 paragrafi 1.1, nenit 84 paragrafi 1, nenit 85 paragrafi 1 pika 1.4 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa**

1. **z. Afrim Limani** nga fsh. Zatriq dhe me vendbanim në fsh. Çifllak, komuna e Rahovecit, me përgatitje profesionale Ekonomist-drejtimi kontabilitet në Universitetin e Prishtinës, **emërohet:**

   **1.1 Drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit.**

2. Detyrat dhe përgjegjësitë të drejtorit të drejtorisë janë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015.

3. Ky emërim fillon nga data **01.04.2022** dhe përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- *Të emëruarit,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
- *Zyrës së personelit, dhe*
- *Arkivit.*

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC
ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komun
Nr./Br./No 1836 Nr. i faq/Br.str/No.pg 347
Data/Datum/Date 01/04/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 pika 2, nenit 17 dhe nenit 24 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015, nenit 74, nenit 81 paragrafi 1.1, nenit 84 paragrafi 1, nenit 85 paragrafi 1 pika 1.7 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë**

1. **z. Afrim Oruqi** nga Rahoveci, me përgatitje profesionale Jurist i diplomuar në Universitetin e Prishtinës, **emërohet:**

   **1.1 Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.**

2. Detyrat dhe përgjegjësitë të drejtorit të drejtorisë janë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015.

3. Ky emërim fillon nga data **01.04.2022** dhe përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- *Të emëruarit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
- *Zyrës së personelit, dhe*
- *Arkivit.*

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR
RAHOVEC ORAHOVAC

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR C.
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1837 Nr. i faq/Br.str/No.pg 347
Data/Datum/Date 01 / 04 / 22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 pika 2, nenit 17 dhe nenit 22 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015, nenit 74, nenit 81 paragrafi 1.1, nenit 84 paragrafi 1, nenit 85 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

## V E N D I M
## Për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

1. **z. Erhan Morina** nga fsh. Xërxë, komuna e Rahovecit, me përgatitje profesionale Master në Banka, Financa dhe Kontabilitet në Universitetin e Prishtinës, **emërohet:**

   **1.1 Drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Komunën e Rahovecit.**

2. Detyrat dhe përgjegjësitë të drejtorit të drejtorisë janë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015.

3. Ky emërim fillon nga data **01.04.2022** dhe përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Të emëruarit,***
- ***Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyrës së personelit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1238 Nr. i faq/Br.str/No.pg 347
Data/Datum/Date 01/04/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 pika 2, nenit 17 dhe nenit 28 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015, nenit 74, nenit 81 paragrafi 1.1, nenit 84 paragrafi 1, nenit 85 paragrafi 1 pika 1.11 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport**

1. z. **Afrim Dina** nga fsh. Celinë Komuna e Rahovecit, i diplomuar në Fakultetin për kulturë fizike dhe sport në Universitetin e Prishtinës, **emërohet:**

   **1.1 Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.**

2. Detyrat dhe përgjegjësitë të drejtorit të drejtorisë janë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015.

3. Ky emërim fillon nga data **01.04.2022** dhe përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Të emëruarit,***
- ***Drejtorisë për Kulturë, Rini dh Sport,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyrës së personelit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
II
RAHOVEC
ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1839 Nr. i faq/Br.str/No.pg 347
Data/Datum/Date 01.04.22
RAHOVEC/ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 pika 2, nenit 17 dhe nenit 27 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015, nenit 74, nenit 81 paragrafi 1.1, nenit 84 paragrafi 1, nenit 85 paragrafi 1 pika 1.10 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për emërimin e Drejtoreshës së Drejtorisë për Inspektim**

1. **znjsh. Nora Boshnjaku** nga Rahoveci, me përgatitje profesionale juriste e diplomua - Baçelor pranë Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", **emërohet:**

   **1.1 Drejtoreshë e Drejtorisë për Inspektim në Komunën e Rahovecit.**

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtoreshës së drejtorisë janë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015.

3. Ky emërim fillon nga data **01.04.2022** dhe përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Të emëruarës,***
- ***Drejtorisë për Inspektim,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyrës së personelit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS / PREDSEDNIK OPŠTINE
RAHOVEC ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1840 Nr. i faq/Br.str/No.pg 347
Data/Datum/Date 01/04/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 pika 2, nenit 17 dhe nenit 29 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015, nenit 74, nenit 81 paragrafi 1.1, nenit 84 paragrafi 1, nenit 85 paragrafi 1 pika 1.12 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim**

1. **z. Kujtim Dina** nga Rahoveci, me përgatitje profesionale Bacelor i juridikut në në Kolegjin "AAB" në Prishtinë, **emërohet:**

   **1.1 Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim.**

2. Detyrat dhe përgjegjësitë të drejtorit të drejtorisë janë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015.

3. Ky emërim fillon nga data **01.04.2022** dhe përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/1531 i datës 08.02.2022.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Të emëruarit,***
- ***Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyrës së personelit, dhe***
- ***Arkivit.***

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC
KRYETARI I KOMUNËS
RAHOVEC ORAHOVAC

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1841 Nr. i faq/Br.str/No.pg 347
Data/Datum/Date 01/04/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 5 pika 2, nenit 17 dhe nenit 25 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015, nenit 74, nenit 81 paragrafi 1.1, nenit 84 paragrafi 1, nenit 85 paragrafi 1 pika 1.8 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

## V E N D I M
### Për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike

1. z. **Përparim Krasniqi** nga fsh. Opterushë Komuna e Rahovecit, me përgatitje profesionale MSC i Sociologjisë Akademike në Universitetin e Prishtinës, **emërohet:**

   **1.1 Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike.**

2. Detyrat dhe përgjegjësitë të drejtorit të drejtorisë janë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Rregulloren për Organizimin e Brendshëm, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës së Komunës së Rahovecit 01. Nr. 1092 datë 27.03.2015.

3. Ky emërim fillon nga data **01.04.2022** dhe përfundon me përfundimin e mandatit të Kryetarit të Komunës, nëse kjo marrëdhënie e punës nuk ndërpritet më herët.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***
- ***Të emëruarit,***
- ***Drejtorisë për Shërbime Publike,***
- ***Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,***
- ***Zyrës së personelit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNËS

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1843 Nr. i faq/Br.str/No.pg 348
Data/Datum/Date 05/04/2022

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot. 02/584/20, i datës: 30.04.2020 për formimin e grupit punues për performancë të komunës**

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi me Nr. Prot. 02/584/20, i datës: 30.04.2020 për formimin e grupit punues për performancë të komunës.

2. Pika 1 e vendimit bazik ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim:
   **1.19** Blerta Gashi, Transparenca komunale
   **1.20** Alban Gashi, Barazia gjinore
   **1.21** Lulzim Krasniqi, Drejtoria për Arsim

3. Pikët tjera të vendimit bazik me Nr. Prot. 02/584/20 i datës 30.04.2020 mbesin të pandryshuara.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***A r s y e t i m***

Me vendimin Nr. 02/584/20, i datës: 30.04.2020 është formuar grupi punues për performancë të komunës së Rahovecit.

Duke marrë parasysh vëllimin e madh të punëve si dhe nevojën e përfshirjes së zyrtarëve të tjerë të drejtorive dhe njësive të ndryshme në kuadër të administratës së Komunës së Rahovecit në këtë grup punues, është e domosdoshme ndryshimi dhe plotësimi i vendimit bazik me Nr. Prot. 02/584/20, i datës: 30.04.2020 për formimin e grupit punues për performancë të komunës.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të grupit punues,***
- ***Drejtorisë për Administratë, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1845 Nr. i faq/Br.str/No.pg 348
Data/Datum/Date 05/04/2022

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, nenit 59 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, i datës: 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

**V E N D I M**
**Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot. 02/1830/22, i datës: 01.04.2022 për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave**

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi me Nr. Prot. 02/1830/22, i datës: 01.04.2022 për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave.

2. Pika 1.1 e vendimit bazik ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim:

   1.1 Luan Sharku, kryesues

3. Pikët tjera të vendimit bazik me Nr. Prot. 02/1830/22, i datës: 01.04.2022 mbesin të pandryshuara.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***A r s y e t i m***

Me vendimin 02/1830/22, i datës: 01.04.2022, është caktuar komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin "Shërbimet e zhvendosjes me merimangë dhe bllokimit të automjeteve në territorin e komunës së Rahovecit" me nr. të prokurimit 623-22-1723-2-2-1 & 623-22-005-2-2-1, të datës: 31.03.2022.
Duke marrë parasysh se Jeton Krasniqi, i cili me vendimin bazik është caktuar kryesues i komisionit gjendet në pushim vjetor, është i domosdoshëm zëvendësimi i tij dhe caktimi i Luan Sharkut.
Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Luan Sharkut,***
- ***Zyrës së Prokurimit, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1855 Nr. i faq/Br.str/No pg 349
Data/Datum/Date 06.04.2022
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 i Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

# VENDIM

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted], komuna e Rahovecit me **Nr. Protokoli 1162**, të dt. **04.04.2022** për ndihmë financiare prej **250.00€** (dyqind e pesëdhjetë euro) për mbulimin e shpenzimeve te mjekimit dhe blerjen e barnave për tretman.

2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

## *Arsyetim*

Halla e [redacted], vuan nga sëmundja e rëndë, e cila ka nevojë për tretman të vazhdueshëm për shërimin e saj. Shërimi i sëmundjes për të lartpërmendurën është tejet i kushtueshëm dhe ka kosto të lartë financiare të papërballueshme për të, pasi që asnjë anëtar i familjes nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme.
Andaj, duke marrë parasysh gjendjen e rëndë shëndetësore dhe financiare të të lartpërmendurit, pasi që shpenzimet e mjekimit dhe të blerjes së barnave kanë kosto të lartë financiare, ai e ka të vështirë mbulimin e shpenzimeve elementare për jetesë dhe blerjen e barnave për shërimin e sëmundjes, kështu që është e domosdoshme ndihma për tejkalimin e kësaj gjendjeje.
Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

***Me vendim të njoftohen:***

- [redacted],
- ***Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,***
- ***Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe***
- ***Arkivi.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA E RAHOVECIT · KRYETARI I KOMUNËS · RAHOVEC ORAHOVAC · REPUBLIC OF KOSOVA · MUNICIPALITY RAHOVEC · MUNICIPAL MAYOR

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 1858 Nr. i faq/Br.str/No.pg 349
Data/Datum/Date 06/04/2022
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

## VENDIM
### Për caktimin e komisionit për asgjësimin e mallit të konfiskuar

1. **Caktohet** komisioni për asgjësimin e mallit të konfiskuar pa leje në hapësirën publike në komunën e Rahovecit në këtë përbërje:

   **1.1.** Saranda Rama, kryesuese
   **1.2.** Valon Hoti, anëtar
   **1.3.** Arta Kabashi, anëtare

2. Komisioni ka për detyrë të bëj vlerësimin dhe asgjësimin e mallit të konfiskuar pa leje në hapësirën publike në komunën e Rahovecit.

3. Obligohet komisioni që këto punë t'i kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.

5. Obligohet komisioni që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Inspektim.

6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të komisionit,***
- ***Drejtorisë për Inspektim, dhe***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E RAHOVECIT - KRYETARI
RAHOVEC ORAHOVAC
REPUBLIKA KOSOVA / OPŠTINA ORAHOVAC / PREDSEDNIK
REPUBLIC OF KOSOVA - MUNICIPALITY RAHOVEC - MUNICIPAL MAYOR

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E RAHOVECIT/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDNIKA/MUNICIPAL MAYOR CABINET
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 186/ Nr. i faq/Br.str/No.pg 349
Data/Datum/Date 07/04/22
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, raportit të vijueshmërisë në punë për muajin shkurt 2022, Kryetari i Komunës së Rahovecit merr këtë:

**V E N D I M**

1. Me këtë vendim bëhet heqja e mëditjes për z. Ruzhdi Kabashi nga fsh. Brestoc Komuna e Rahovecit, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës Auditor i Brendshëm pranë Njësisë për Auditim të Brendshëm në Zyrën e Kryetarit të Komunës për muajin shkurt 2022.

2. Heqja e mëditjes sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet pasi që i lartpërmenduri ka munguar në punë gjatë muajit shkurt dhe i njëjti nuk e ka arsyetuar mungesën e tij.

3. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa në Komunën e Rahovecit që ta bëjë heqjen e mëditjes, duke u bazuar në pagën neto të të lartpërmendurit.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

